



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 7
Prishtinë, më 24.2.2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Fadil Demaku, zëvendëskryetar i parë, Ganimete Musliu, Anton Quni, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Mungoi: Bojan Mitiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ardiana Gashi-OSBE; Lumnije Murati-Zyra e Presidentes së Kosovës; Krenare Loxhaj-QKSS; Adem Gashi- Ambasada Amerikane në Prishtinë, Luanda Domi-DCAF.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit;

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Kryetari- Fillimisht përshëndeti anëtarët e komisionit dhe të pranishmit. Tutje theksoi se për shqyrtimin e këtij projektligji kemi rënë dakord që të jemi të gjithë anëtarët e Komisionit. Gjithashtu njoftoi se janë pranuar disa propozim-amendamente nga z. Rexhep Selimi për projektligjin në fjalë. Gjithashtu edhe nga deputeti Zafir Berisha është bërë një propozim-amendament, ku ka paraqitur vërejtje për nenin 1.

Tutje vazhdoi me prezantimin e projektligjin në monitor, ku në kolonën e mesme janë paraqitur propozim-amendamentet e deputetit Rexhep Selimi, të cilat janë të plotësuara nga ato që janë sjell më herët nga deputeti Faton Topalli si dhe propozim-amendamenti i deputetit Zafir Berisha. Fjalën ia kaloi z.Rexhep Selimi.

Rexhep Selimi- Njoftoi se amendamentet e propozuara nga z.Faton Topalli janë tërhequr nga ana e tij dhe se grupi parlamentar i vetëvendosjes ka punuar në amendamente të tjera të cilat do ti prezantoj në vijim dhe të cilat i kam dorëzuar tek kryetari dhe administrata.

Tutje theksoi se amendamenti i parë ka të bëjë me ndryshimin e titullit të këtij projektligji, me qëllim që të jetë më përcaktues. Propozimi është që titulli i projektligjit të jetë “projektligj për pjesëmarrjen në konflikte të armatosura ose luftëra të mbështetura nga organizata apo grupime me aktivitet terrorist”.

Arsyetimi për këtë është se, me këtë emërtim përshihen premiset e rregullimit të këtij projektligji dhe se përmbajtja e projektligjit të jetë në përputhje me emërtimin e tij.

Tutje lexoi arsyetimin e amendamentit të dytë, që ka të bëjë me nenin e parë. Pra, me qëllim të mbrojtjes së interesit shtetëror dhe sigurisë kombëtare ky ligj përcakton veprën penale të bashkimit apo pjesëmarrjes në konflikte të armatosura ose luftëra, të mbështetura nga organizata apo grupime me aktivitet terrorist të shpallura me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës ose nga organizatat ndërkombëtare. Kur thuhet organizatat ndërkombëtare, më poshtë në amendamente të tjera ne i referohemi Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian. Për këtë kërkoi mbështetje nga ana e Komisionit.

Kryetari- Gjithashtu nga ana e z.Zafir Berisha, është sjell një amendament që i referohet nenit 1. Fjalën ia kalo z.Berisha.

Zafir Berisha- Theksoi se edhe në seancë ka mbrojtur këtë qëndrim me qëllim të ndryshimit të nenit 1, me qëllim të përcaktimit më të saktë të qëllimit të këtij projektligji. Për këtë arsye ka propozuar që si shtojcë të jetë luftërat terroriste, okupuese që cilësohen të tilla nga mekanizmat ndërkombëtar që synon të jetë Kosova, siç është NATO-ja, BE-ja. Gjithashtu vlerësoi se Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Jashtme, duhet të ketë qëndrim për luftërat që ndodhin sot në botë. Kjo për arsyeje se në vendet e rajonit ku jetojnë shqiptarët shpeshherë ka turbulenca dhe ky projektligj nuk duhet të jetë si pengesë pasi duhet të kemi parasysh këtë rajon, siç është në Maqedoni, mal të Zi dhe Preshevë, ku jetojnë shqiptarët. Për këtë arsye projektligji duhet të jetë më preciz. Gjithashtu Qeveria duhet të jetë më e matur në deklaratat e saj ndaj konflikteve që

ndodhin në botë dhe do të ishte mirë, që me një udhëzim administrativ të bëhej një listë e organizatave që nuk bëjnë luftë të drejtë.

Nuredin Ibishi- Bëri vërejtje në lekturimin e tekstit të projektligjit, dhe sugjeroi që këto gabime teknike të përmirësohen. Gjithashtu propozoi që të bëhet një amendament i veçantë, me qenë si sugjeroi që Qeveria kur të sjell projektligjet me qenë në rregull sipas standardeve të hartimit të ligjeve.

Fadil Demaku- Konsideroi se projektligji siç është sjell është mirë i plotësuar dhe e arrijnë synimin për të cilin është krijuar. Vlerësoi kontributin e deputetëve për amendamentet që kanë sjell por konsideroi se amendamentet nga grupi parlamentar i Vetëvendosjes e humbin kuptimin esencial të projektligjit. Ndërsa për amendamentin e z. Berisha tha se e vlerëson qëllimin për të cilin e synon , marrë në konsideratë problemin e përgjithshëm të shqiptarëve në rajon, por vlerësoi se si vend i pavarur ligjet duhet ti bëjmë konform pozitës që jemi. Gjithashtu duhet shmangur krijimi i ligjeve tendencioze, prandaj vlerësoi se ky projektligj është i plotë dhe është i mjaftueshëm që të kalon.

Kryetari- Përkrahjen ose jo të amendamenteve e bëjmë me vota, në mënyrë që të shmangim debatin. Natyra e ligjit është preventive dhe dhënia e të drejtës për të vepruar organeve të ndjekjes

Ganimete Musliu- Vlerësoi se projektligji në fjalë ka qenë edhe në legjislaturën e kaluar, kemi ardhës në përfundimin që këtu duhet të jemi me këtë materie dhe të dërgomë në Kuvend edhe për lexim të dytë dhe të procedohet tutje. Sa i përket nenit 1, vlerësoi se ky nen përmbush kërkesat për të cilat është nxjerrë. Vlerësoi kontributin e kolegëve për amendamentet që kanë bërë, por konsideroi se siç është projektligji aktualisht është koncizë. Prandaj vlerësoi që si komision duhet ta procedojmë në kohë dhe të jetë i përgatitur.

Anton Quni- Vlerësoi se duhet të kemi parasysh që të bëhen çfarëdo ndërhyrje, se me këtë projektligj ne nuk trajtojmë vetëm kyçjen e qytetarëve të Kosovës në Organizata terroriste, por implikimi i tyre në çfarëdo krize, konflikte, luftëra akte terroriste etj. Të gjitha këto forma të dhunshme, të armatosura nuk janë statike, nuk janë të pandryshueshme, ato evoluojnë në dinamikë, intensitet, karakter, pamje, metoda etj.

Diçka që sot mund të jetë e drejtë, pa asnjë kohe mund të karakterizohet si e pa drejtë apo e kundërta. Kështu që është shumë problem të lihet në vullnetin e qytetarit të bëjë cilësimin e një veprimi, të një etnie, kombi, subjekti se a është e moralshme apo jo për ndonjë kauzë, ai vet të jetë në shërbim të saj. Ne nëse pretendojmë të jemi shtet i qytetëruar dhe duke përdorur praktikën e mira perëndimore, çdo reagim i joni, karshi situatave të tilla duhet të jetë reagim institucional. Dhe nëse ka nevojë nën ombrellën e organizatave ndërkombëtare, të Kombeve të Bashkuara të NATO-s, BE-së, atëherë institucionet adekuate të jenë pjesë e këtyre përpjekjeve ndërkombëtare.

Nuk duhet të krijojmë mundësi, që pas disa akteve, normave juridike, ne tu mundësojmë qytetarëve tanë të jenë viktimë e ligjeve, të cilat ne do ti miratojmë me ndryshime, nëse një organizatë e ka një emërtim dhe ne e cilësojmë si organizatë terroriste, kurse të nesërmen ajo

organizatë shfaqet me një emër tjetër, dhe natyrisht kjo organizatë dhe ata të cilët janë në shërbim të saj, mund ti ikin drejtësisë. Prandaj unë e shosh shumë më të arsyeshme, projektligjin në këtë formë si është i formuluar, mendoj që është më funksional dhe më parandalues që qytetarët e Kosovës mos të jenë viktimë dhe mos të bien pre e situatave të ndryshme që krijohen në rajon apo edhe më larg.

Rexhep Selimi- Lidhur me amendamentet e propozuara sqaroi se, me ndryshimin e titullit është synuar të qartësohet qëllimi i projektligjit. Pasi situata e cila është krijuar është e pa pranueshme për të gjithë qytetarët e Kosovës, ku shumë qytetar janë pjesë e organizatave siç janë ISIS, Al-kaida etj. Për këtë arsye vlerësoi se listimi i organizatave dhe saktësimi i titullit të projektligjit e ndihmon. Në përfundim të diskutimit vlerësoi se do të ishte më se e domosdoshme që nga ana e Qeverisë të bëhet lista e këtyre organizatave dhe përditësimi i kësaj liste, e cila do të ndihmonte për të vlerësuar pjesëmarrjen në një luftë të drejtë apo jo.

Kryetari- Pasi janë një numër amendamenteve të propozuara nga z.Rexhep Selimi, fjalën ia kaloi z.Selimi.

Rexhep Selimi-Vlerësoi që si rrjedhojë e ndryshimit të titullit të këtij projektligji, ku titulli është Projektligj për pjesëmarrje në Konfliktet të Armatosura ose luftëra të organizuara dhe të mbështetura nga organizata me aktivitet terrorist, ne parashohim që në këso aktiviteti terrorist nuk është paraparë apo nuk merr asnjë institucion i sigurisë shtetëror.

Prandaj ne kemi paraparë që, aty ku është paraparë në Nenin 2 ku thuhet që dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen ndaj shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë shtetësi të shteteve të huaja dhe janë pjesë e ushtrisë dhe formacioneve ushtarake të tyre ose shërbejnë në formacione ushtarake në kontrollin e Qeverive demokratike, por ne mendojmë që asnjë ushtri në një qeveri demokratike, nuk do ta mbështeste një aktivitet në përputhje me ligjin, prandaj ne e kemi menduar që si rrjedhojë e ndryshimit të titullit, ky nen të hiqet për shkak se nuk parashohim që një ushtri e një qeverie e njohur ndërkombëtarisht mund të jetë në mbështetje të aktiviteteve terroriste të një organizimi siç është paraparë në titull.

Prandaj, arsyetimi është që si rrjedhojë e ndryshimit të titullit, ky nen duhet të bie poshtë.

Kryetari- A ka dikush të shtoj diçka rreth kësaj teme?

Rexhep Selimi- Amendamenti katër, që ka të bëjë me paragrafit tre të këtij neni, ku thuhet që dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për strukturat e sektorit të sigurisë së Kosovës të cilat sipas ligjit veprojnë jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Edhe ky nen, si pasojë e ndryshimit eventualisht të titullit do duhej të ndryshonte, pasi edhe paragrafi dy dhe tre, kanë kuptim nëse mbetet titulli i caktuar, por nëse ndryshohet titulli, duhet të bie për shkak se nuk parashihet që Forcat e Sigurisë së Kosovës të marrin pjesë ose të përfshihen në ndonjë aktivitet të tillë që parashihet në nenin 1 të këtij projektligji.

Propozuesi konsideron, në këtë rast Unë, se kjo dispozitë është e pa nevojshme kur e kemi parasysh që Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligj të veçantë, me të cilën është rregulluar çështja e pjesëmarrjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës në misione jashtë vendit. Në legjislaturën e kaluar është miratuar një ligj, për pjesëmarrjen e FSK-së jashtë vendit. Për këtë një theksim i tillë është i panevojshëm, sidomos, kur e kemi parasysh që çështja e pjesëmarrjes

në formacione legjitime të Republikës së Kosovës, është fakt dhe për këtë nuk duhet një konfirmim i veçantë, pra ne mendojmë edhe një herë që nëse ndryshohet neni 1 të qëllimi dhe titulli, normalisht që FSK-ja nuk parashihet të marrë pjesë në konflikte të tilla, kështu që si rrjedhojë, prapë të ndryshimi, të qëllimi tek neni 1, mendojmë që të hiqet edhe kjo.

Nuredin Ibishi- Nëse shkojmë nën për nën, është mirë edhe të miratohet edhe kush i përmbahet amendamentit të vet.

Rexhep Selimi- Kryetari e propozoi në fillim që votimet mund të bëjmë në fund të kësaj mbledhje ose në mbledhje tjetër. Kërkoj që votimi i amendmaneteve që ka propozuar, të bëhet në mbledhjen paraprake para se të procedohet për në leximin e dytë projektligji, në mënyrë që të keni kohë edhe ti lexoni para se të votohen. Pasi për shkaqe praktike nuk ka mundur ti sjell më herët, por sot vlerësoj që nuk ka nevojë të votohen amendamentet pasi i votojmë në mbledhjen para se të kaloj projektligji në lexim të dytë.

Kryetari- Arsyeja që e kemi bërë këtë sistem pune është se përmasat e propozim amendamenteve të Vetëvendosjes, dhe meqenëse u tha në fillim që është grup punues në vendimet këtu i marrim me votim. Kërkoj nga propozuesi që të lexoj fjalë për fjalë çfarë kanë kërkuar, meqenëse jeni vonuar në propozime, jo me kohën ligjore por jeni vonuar për shkak të thirrjes së këtij takimi.

Gjithashtu vlerësoi se kur thuhet që duhet të hiqet ajo apo kjo pikë, nuk po ndërhyjë për shkak se këto janë propozime të deputetit Selimi. Ashtu siç nuk ndërhyjë në propozimet e z.Berisha edhe pse për mua, po mos të ishte ndërhy në Kushtetutë, deputeti Berisha ka të drejtë.

Rexhep Selimi- Kërkoj sqarim për procedurat që i ndjekin, pasi sot jemi edhe Komisioni edhe grupi punues dhe nuk votohen amendamentet pasi ato votohen në mbledhjet e Komisionit, para se të shkohet në seancë. Kjo është kërkesë dhe kurdo që ju vlerësoni mund ti votojmë. Ndërsa sa i përket arsyetimit të amendamenteve, them që nuk do duhej të keqkuptohemi, nëse ndryshon titulli dhe qëllimi, atëherë nuk ka pse të përfshihet paragrafi dy dhe tre i Nenit dy. Pra si rrjedhojë bien këta dy paragraf, pasi nuk parashohim ne që FSK-ja mund të jetë mbështetëse, edhe një herë sa për sqarim po them që nëse ndryshohet titulli dhe qëllimi, këta dy paragraf nuk duhet të jenë, por nëse nuk ndryshohet duhet të jenë patjetër.

Kryetari- A ka dikush prej kolegëve diçka, për të shtuar në këtë temë. Nëse jo, atëherë shkojmë me amendamentin e gjashtë, neni 4, të shtohet një nën i ri, me numër rendor 5, përmbajtja si në vijim: neni 5, Hartimi dhe shpallja e listave, të organizative, grupimeve dhe individëve në aktivitete terroriste.

Kryetari- A ka dikush prej kolegëve diçka, për të shtuar në këtë temë. Nëse jo, atëherë shkojmë me amendamentin e gjashtë.

Rexhep Selimi- Ne kemi propozuar, jo ndryshim por plotësim të këtij projektligji dhe besoj që këtë projektligj e bënë edhe më komplet të shtohen këto nene dhe i zbaton Qeveria e Republikës së Kosovës, ku parashihet që pas nenit katër të shtohet një nën i ri, me numër rendor 5, si në

vijim: Neni 5, hartimi dhe shpallja e listës të organizatave, grupimeve dhe individëve me aktivitet terrorist. Siç thashë edhe më herët, mendoj që Qeveria e Republikës së Kosovës, do duhej ta bënte një gjë të tillë, në analogji me organizatat ndërkombëtare, duke iu referuar, Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Gjermanisë, Zvicrës dhe shteteve të tjera me Qeveri demokratike.

Pra, pika 1, Qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjin penal dhe aktet ndërkombëtare, dokumentet e organizatave ndërkombëtare, duhet të hartoj dhe të shpall listën e organizatave, grupimeve me aktivitet terrorist, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës, edhe një herë e them, që do të duhej të përfshihej brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës, për shkak se ne nuk jemi imun, ndaj aktiviteteve të organizatave terroriste edhe brenda territorit të Republikës së Kosovës, pra nuk do të duhej që asnjëherë ta përjashtonim si të tillë.

Pra ky është arsyetimi dhe përkufizimi për pikën e parë të nenit 5. Pika e dytë e nenit pesë: Lista e organizatave me cilësim dhe veprimtari terroriste nga paragrafi 1 i këtij neni, të jetë e bazuar në listën e përditësuar të Organizatës së Këmbëve të Bashkuara dhe listën autonome të Bashkimit Evropian. Pika tre, në listën e Qeverisë, nga paragrafi 1 i këtij neni do të jenë të përfshira edhe organizatat e huaja të cilat veprojnë brenda territorit të Republikës së Kosovës pa lejen e autoriteteve dhe të cilat me veprimtarinë e tyre, cenojnë sovranitetin territorial të Republikës së Kosovës.

Pika katër, përditësimi i kësaj liste realizohet nga Qeveria e Kosovës, sipas nevojës dhe rrethanave jo më vonë se 30 ditë nga marrja e të dhënave të reja. Pra jo në aspektin periodik, por ku të ka të dhëna të reja e përditëson dhe pika e pestë e këtij neni, mënyra e hartimit dhe procedurat e shpalljes rregullohen me akt normativ të veçantë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ne e parashohim që neni 5 do ta plotësonte shumë mirë këtë ligj, me pesë pika propozuesi konsideron se ekzistimi i një liste publike e cila do të jete e miratuar në një procedurë qeveritare dhe vendim formal nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është në interes të informimit publik por edhe në aspektin e lehtësimit të aspektit të konstatimit të gjendjes reale, midis veprimit të kryerjes së veprës së sanksionuar. Qëllimi parësor i këtij neni të propozuar, është që në mënyrë përkatëse të jetë formuluar lista e cila do të përfshinte organizatat me emërtim dhe veprimtarinë e saj terroriste. Pra emërtim dhe veprimtari, pavarësisht se mund ta ndërroj emërtimin e veprimtarisë dhe që e gjithë kjo të jetë në interes të sigurisë kombëtare.

Kërkoj edhe një herë vlerësim edhe përkrahjen për shtimin e një neni në këtë projektligj, ku mendojmë që do ta pasuronte këtë projektligj dhe do të ishte më i plotësuar.

Kryetari- A ka dikush diçka? Nëse jo shkojmë me amednmamentin e shtatë. Pas nenit pesë, të shtohet edhe një nen, pra neni gjashtë me këtë përmbajtje. Është propozim nga Vetëvendosja, amendamenti i shtatë.

Rexhep Selimi- Ne e propozojmë edhe amendmanetin e shtatë, ku pas nenit të pestë të shtohet edhe një nenë me këtë përmbajtje:

Neni 6, përkufizimi i aktivitetit terrorist të një organizate, grupimi apo individëve përcaktohet me ligj të veçantë kundër terrorizmit. Pra, ne kemi edhe analogji të tjera të ligjeve, ku brenda një ligji kërkohet të ketë listë të veçantë, pra i bie që ky ligj të jetë iniciativë që në Kosovë të ketë edhe ligj kundër terrorizmit, pra në mënyrë që të kemi ligj përtej Kodit të Procedurës Penale, atë

kundër terrorizmit. I bie që ky ligj mund të jetë iniciativë ose pikënisje e mirë për të pasur Kosova edhe një ligj kundër terrorizmit, që nuk e ka por lufta kundër terrorizmit është e përfshirë në Kodin e Procedurës Penale.

Tutje propozoi amendamentin e tetë, neni gjashtë, ku neni gjashtë i shtohet edhe një nen me këtë përmbajtje. Neni shtatë: Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, shpall në njoftim publik, listën e personave shtetas të Kosovës(që nuk e kemi)ose me vendim ose me leje qëndrimin në Republikën e Kosovës të kërkuar për veprimtari terroriste.

Personat e publikuar në listë do të përfshihen në listë, vetëm nëse për këtë vlerësohen nga prokuroria e shtetit, se hetimet apo ndjekja e personit në fjalë, nuk do të dëmtonte nga publikimi i të dhënave të personit.

Pra ne kërkojmë, që Ministria e Punëve të Brendshme, të ketë listën e saj për personat e kërkuar, përveç nëse Prokuroria e shtetit kërkon një gjë të tillë, që mos të publikohet për shkaqe sigurie.

Nuredin Ibishi- Bëri vërejtje tek Neni 3, paragrafi i katërt, ku thotë: Kushdo që në mënyrë publike, ti shtohet ose individuale, në tubime, etj., për arsye se nuk shkon krejt në formën e qasjes publike, pasi dihet rrjetet sociale, aspekti i indoktrinimit i qasjes në rrjetet sociale, edhe adresat e formave të ndryshme. Pra nuk është diçka që bënë vetëm publikisht, por është edhe një formë interne ose individuale, për këtë arsye mendoj që kjo duhet të shtohet, pasi nuk është përherë publike qasja.

Kryetari- Duke iu referuar pikës katër, të neni 2 që thotë “Kushdo që në mënyrë publike, në tubim ose me anë të shkrimeve, xhirimeve audiovizuale, duke përfshirë dhe mos u kufizuar edhe në rrjetet sociale ose në çfarëdo forme tjetër të komunikimit, thërret ose nxit të tjerët për kryerjen e veprave penale të përcaktuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5)vite.” Këto bien në ndesh me njëra tjetrën, nëse e heq një e shmang tërësinë, ky është mendimi im.

Nuredin Ibishi- Tek neni i 4, paragrafi 3, procedurat për hetimin e ndjekjeve të kryerësve të veprës penale, të përcaktuar në këtë ligj dhe shqiptimi i dënimit zhvillohet në bazë të Kodit të Procedurës Penale. Konsideroi se duhet plotësuar, duke thënë edhe sipas ligjeve në fuqi. Pasi nëse flet për shqiptimin e dënimit për vepra penale, atëherë në rregull është me kodin penal, nëse flasim për aspektet e hetimeve, këtu i kemi edhe ligjet që nuk janë vetëm në Kodin e Procedurës Penale, siç janë masat e fshehta të vëzhgimit, por janë edhe në ligje të tjera, siç është Ligji për AKI-në dhe procedurat standarde të veprimit, pra të shtohet që përveç Kodit të procedurës Penale edhe Ligjeve në fuqi, pasi mbetet e mangët.

Edhe te pika e katërt e këtij neni, te rreshti i tretë të shtohet, përveç Kodit të procedurës Penale edhe ligjeve në fuqi. Mandej te pika e pestë, gjithashtu kur flasim për dispozitat e sekuestrimit dhe konfiskimit. Këtu po flet vetëm për pasurinë e përfituar në mënyrë të kundërligjshme që ka të bëjë me vepra penale, çka edhe mjetet që mund të jenë, armët fondet, pasuria e tjetër që është përfituar në mënyrë të kundërligjshme në angazhim të tyre, në konflikte të armatosura, siç janë mercenarët.

Mendoj që kjo dispozitë, apo paragrafi i pestë, duhet të thjeshtësohet dhe të thuhet: Dispozitat për sekuestrim dhe konfiskim, të mjeteve, fondeve dhe pasurisë, mund të zbatohet

përshtashmërisht për veprat penale, të përcaktuara në ligjet në fuqi, pra kjo duhet të jetë gjithëpërfshirëse, sepse këtu nuk ka të bëjë vetëm për konfiskimin e pasurisë, në formë të kundërligjshme, që e ka fituar prej angazhimit të tij, që mund ta ketë fituar si mercenarë. Por ka të bëjë që ai ka mjete të rrezikshme, siç mund të jenë mjetet e shkatërrimit në masë, të cilat duhet ti konfiskohen dhe sekuestrohen. Pra ka të bëjë me mjete, fonde edhe pasuri. Mendoj që kjo duhet të amendamentohet pasi është e fokusuar vetëm në një çështje, siç është konfiskimi i pasurisë në formë të kundërligjshme dhe nuk ka të bëjë me mjetet e rrezikshme dhe fonde të tjera, që mund të jenë për ngritje të kapaciteteve të organizatave në konflikte të armatosura.

Fadil Demaku- Propozoi një pauzë në mënyrë që të bëhen plotësimet e amendamenteve që u thanë dhe më pas të vazhdohet takimi në mënyrë që të dihet ëprkrahja e amendamenteve.

Kryetari- A pajtoheni që të vazhdojmë pas pauzës apo të shtyjmë për mbledhjen e radhës?

Me shumicë të votave u votua propozimi për vazhdimin e takimit pas pauzës.

Kryetari- E rihapim takimin dhe fillojmë me votimin nga titulli i Projektligjit. E hedhim në votim propozim-amendamentin e parë nga deputeti Rexhep Selimi me këtë përmbajtje:

Amandament I:

Ndeshohet emërtimi i Projektligjit nga “PROJEKTLIGJ PËR NDALIMIN E BASHKIMIT NË KONFLIKTE TË ARMATOSURA JASHTË TERRITORIT TË VENDIT” në “PROJEKTLIGJ PËR PJESËMARRJES NË KONFLIKTE TË ARMATOSURA OSE LUFTËRA, TË ORGANIZUARA DHE MBËSHTETURA NGA ORGANIZATA APO GRUPIME ME AKTIVITET TERRORIST”

Me gjashtë vota kundër(Fadil Demaku, Nuredin Ibishi, Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami), një për(Rexhep Selimi), dy abstenim(Daut Haradinaj, Zafir Berisha).

Kryetari- Hedhim në votim propozim-amendamentin e z.Zafir Berisha me këtë përmbajtje:

Më qëllim të mbrojtjes së interesit shtetëror dhe sigurisë kombëtare, ky ligj përcakton veprën penale të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individualisht, në çfarëdo forme të konflikteve të armatosura jashtë territorit të Republikës së Kosovës. **Ku nga organizma ndërkombëtare si OKB, NATO, BE si dhe Qeveria e Kosovës i cilëson luftëra okupuese ose aktivitete terroriste konfliktet e caktuara në botë**

Me pesë vota kundër(Daut Haradinaj, Fadil Demaku, Nuredin Ibishi, Anton Quni, Ganimete Musliu,), dy për(Zafir Berisha, Qerim Bajrami), një abstenim(Rexhep Selimi). Shkojmë me amendamentin dytë, propozuar nga deputeti i Vetëvendosjes Rexhep Selimi me këtë përmbajtje:

Amandamenti II:

Në Nenin 2 i Projektligjit riformulohet me këtë përbërje:

Neni 1 Qëllimi

Më qëllim të mbrojtjes së interesit shtetëror dhe sigurisë kombëtare, ky ligj përcakton veprën penale të bashkimit apo pjesëmarrjes në konflikte të armatosura ose luftëra, të organizuara dhe mbështetura nga organizata apo grupe me aktivitete terrorist të shpallura si të tilla me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe/ose nga Organizata Ndërkombëtare relevante.

Kush është për?(Rexhep Selimi) Kush është kundër?(Daut Haradinaj, Fadil Demaku, Anton Quni, Ganimete Musliu, Nuredin Ibishi, Abstenim?(Zafir Berisha)

Vazhdojnë tutje, me amendamentin e tretë, katërt, të pestë, të gjashtë, shtatë dhe të tetë me këto përmbajtje:

Amandament III:

Fshihet paragrafi 2 i Nenit 2 të Projektligjit.

Amandament IV

Fshihet paragrafi 3 i Nenit 2 të Projektligjit.

Amandament V:

Fshihet paragrafi 4 i Nenit 3 të Projektligjit.

Amandament VI

Pas Nenit 4 të shtohet një nen i ri me numër rendor 5, me përmbajtje si në vijim:

Neni 5

Hartimi dhe shpallja e listës së organizatave, grupeve dhe individëve me aktivitete terrorist

1. Qeveria e Republikës së Kosovës në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe ligjin penal, aktet ndërkombëtare dhe dokumentet e organizatave ndërkombëtare duhet të hartojë dhe të shpallë listën e organizatave, grupeve me aktivitete terrorist, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

2. Lista e organizatave me cilësim të veprimtarisë terrosite nga paragrafi 1 i këtij Neni do të jenë të bazuara në listat e përditësuara të Organizatës së Kombeve të Bashkuar dhe listës autonome të bashkimit Evropian.
3. Në listën e Qeverisë nga parafila 1 i këtij neni do të jenë të përfshira edhe organizatat e huaja të cilat veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës pa lejen e autoriteteve dhe të cilat me veprimtarinë e tyre cenojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës.
4. Përditësimi i kësaj liste realizohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas nevojës dhe rrethanave jo më vonë se 30 ditë nga marrja e të dhënave të reja.
5. Mënyra e hartimit dhe procedurat e shpalljes rregullohen me akt normativ të veçantë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Amandamenti VII

Pas Nenit 5 të shtohet edhe një nen me këtë përmbajtje:

Neni 6

Përkufizimi i aktivitetit terrorist të një organizate, grupimi apo individëve përcaktohen me ligj të veçantë kundër terrorizmit.

Amandamenti VIII

Neni 6 të shtohet edhe një nen me këtë përmbajtje:

Neni 7

Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës shpall në njoftim publik listën e personave shtetas të Kosovës, ose me vendbanim, ose me leje qëndrimi në Republikën e Kosovës, të kërkuar për veprimtari terroriste. Personat e publikuar në listë do të përfshihen vetëm nëse për këtë vlerësohet nga Prokuroria e Shtetit se hetimet apo ndjekja e personit në fjalë nuk do të dëmtohet nga publikimi i të dhënave të personit.

Kush është për amendamentet e lartëcekura?(Rexhep Selimi), kundër(Daut Haradinaj, Fadil Demaku, Anton Quni, Nuredin Ibishi, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami). Abstenim?

Votohet në tërësi ligji. Kush është për?(Daut Haradinaj, Fadil Demaku, Nuredin Ibishi, Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami). Kundër? (Rexhep Selimi).

Pra, të gjitha propozimet do të shkojnë në seancë, ku do të marrin vendimin përfundimtar. Në përfundim të takimit falënderoi për kontributin dhe e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj